

20210771165

**LIGJ I HUAMARRJES I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NGA BANKA  
NDËRKOMBËTARE E RINDËRTIMIT DHE E ZHVILLIMIT - BANKA BOTËRORE  
SIPAS MARRËVESHJES SË HUAZIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË  
EFIKASITETIT ENERGJETIK NË SEKTORIN PUBLIK**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua prej 25.000.000 euro nga Banka Ndërkombëtare e Rindërtimit dhe e Zhvillimit - Banka Botërore, të dedikuar për realizimin e Projektit të efikasitetit energjetik në sektorin publik.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas së nenit 1 të këtij ligji përcaktohen me Marrëveshjen e huazimit për financimin e Projektit të efikasitetit energjetik në sektorin publik, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit - Bankës Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshjen e huas, sipas paragrafit 1 të këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Afati i shlyerjes së huas nga neni 1 i këtij ligji është 12 vjet, me periudhë të përfshirë grejs prej tre vjet.

Shkalla e kamatës është EURIBOR gjashtëmuor i rritur për shtrirje fikse.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së huas, sipas nenit 2 paragrafi 1 të këtij ligji, Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit - Bankës Botërore provizion të njëhershëm prej 0,25% të shumës së huas.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit - Banka Botërore provizion në lartësi prej 0,25% të pjesës së patërhequr të huas në nivel vjetor.

Huaja do të shlyhet në 18 këste gjysmëvjetore, prej të cilave 17 këste gjysmëvjetore, secili prej 5,56% të shumës së huas, ndërsa kësti i fundit i 18-të prej 5,48% të shumës së huas. Huaja do të shlyhet çdo vit, më 15 mars dhe 15 shtator.

Neni 4

Shfrytëzues të mjeteve të huas së nenit 1 të këtij ligji janë komunat e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qyteti i Shkupit dhe komunat e Qytetit të Shkupit të cilat i plotësojnë kushtet për huamarrje në pajtim me Ligjin e Borxhit Publik dhe Ligjin e Financimit të Njësisive të Vetëqeverisjes Lokale, Institucionet e Shëndetit Publik, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave dhe Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut në strukturën e së cilës do të formohet Fondi i Efikasitetit Energjetik.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe shfrytëzuesve të mjeteve të huas nga neni 4 i këtij ligji (komunat në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit), Ministria e Financave do të lidhë marrëveshje të veçanta për hua.

Neni 6

Republika e Maqedonisë së Veriut huan e nenit 1 të këtij ligji do ta shlyejë me mjete të cilat do të grumbullohen me pagimin e një pjese të mjeteve të huazuara nga shfrytëzuesit e huas së nenit 4 të këtij ligji (komunat e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qyteti i Shkupit dhe komunat e Qytetit të Shkupit) dhe nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 7

Ky ligji hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".